



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 02 Shkurt 2021

Nr: 01

UDHËZIM

**PËR CAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËRZGJEDHJEN E MONITORUESVE,
PROCEDURËN, EMËRIMIN DHE OBJEKTIN E MONITORIMIT**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “ë”, e 2, dhe nenit 92/4 të ligjit nr. 10019, datë 28.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

U D H Ë Z O J:

Neni 1

Objekti

Ky udhëzim ka për objekt të përcaktojë:

- kriteret e përzgjedhjes, procedurën dhe emërimin e monitoruesve;
- objektin e monitorimit, periudhën e monitorimit, përcaktimin e subjektit/subjekteve të monitorimit dhe zonën gjeografike ku shtrihet monitorimi prej monitoruesve; dhe
- raportimin e monitorimit në mënyrë të pavarur, të paanshme, jo diskriminuese dhe transparente.

Neni 2

Qëllimi i monitorimit

Monitorimi nga monitoruesit bëhet në emër dhe për llogari të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe synon vlerësimin për shkallën e përputhshmërisë së veprimtarisë së partive politike, subjekteve zgjedhore dhe kandidatët e tyre me kushtet dhe kërkesat e Pjesës VII, Kreu I, të Kodit Zgjedhor,



Data: 02 Shkurt 2021

Nr. 01

“Për caktimin e kriterëve për përzgjedhjen e monitoruesve, procedurën, emërimin dhe objektin e monitorimit”

respektimin e përcaktimeve të bëra në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve” dhe në aktet e tjera nënligjore të nxjerrë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Neni 3

Periudha e monitorimit dhe emërimi i monitoruesve

1. Periudha e monitorimit është 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve dhe deri në datën e zgjedhjeve.
2. Jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj para datës së zgjedhjeve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve emëron një numër të mjaftueshëm monitoruesish për monitorim sipas këtij udhëzimi.
3. Pas emërimit dhe para fillimit të periudhës së monitorimit sipas këtij neni monitoruesit i nënshtrohen trainimit nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Neni 4

Objekti i monitorimit dhe emërimit të monitoruesve

1. Monitorimi sipas këtij udhëzimi kryhet kur është i verifikueshëm lehtësisht dhe kufizohet me vëzhgimin e:
 - a) respektimit të detyrimeve ligjore dhe nënligjore nga ana e partive politike, subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve gjatë periudhës së monitorimit;
 - b) veprimtarisë së institucioneve publike qendrore/vendore e organeve në varësi të tyre me qëllim parandalimin e veprimtarive të ndaluara apo përdorimin e burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Pjesën VII, Kreu I të Kodit Zgjedhor dhe vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 9, datë 24.12.2020 “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve.”
2. Përzgjedhja dhe emërimi i monitoruesve bëhet në bazë të parimit të konkurimit të lirë, të



barabartë dhe garancisë për mungesën e konfliktit të interesave.

3. Monitoruesi duhet të ushtrojë përgjegjësitë dhe të kryejë detyrat e tij në mënyrë të paanshme dhe jo diskriminuese. Monitoruesi gjatë periudhës së monitorimit nuk mund të kryejë veprimtari që bien ndesh me qëllimin e monitorimit.
4. Subjekti/subjektet e monitorimit, zona gjeografike e monitorimit për çdo monitorues, kushtet e shërbimit për monitorimin së bashku me shpërblimin për monitoruesin përcaktohet në kontratën e shërbimit sipas kontratës tip, të miratuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Kontrata e Shërbimit duhet të përmbajë edhe parashikimin e ndërprerjes së menjëhershme të saj në rast se monitoruesi nuk realizon përgjegjësitë dhe detyrat e përcaktuara në këtë udhëzim.

Neni 5

Modalitetet e monitorimit dhe mënyra e raportimit

1. Monitorimi kufizohet në vëzhgimin e respektimit lehtësisht të verifikueshëm të detyrimeve të partive politike, subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve të tyre për periudhën e monitorimit, të tilla si përdorimin e materialeve propagandistike, zyrave elektorale, materialeve propagandistike elektorale, të tubimeve, të takimeve, të eventeve etj, si dhe respektimin e ndalimeve dhe kufizimeve për veprimtari të caktuara para datës së zgjedhjeve dhe/ose shpërdorimit të burimeve shtetërore gjatë periudhës së monitorimit. Monitoruesit realizojnë edhe vëzhgimin e organeve të administratës shtetërore qendrore ose vendore, apo titullarëve të tyre nëse zbatojnë detyrimet e përcaktuara në Pjesën VII, Kreu I të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
2. Monitoruesi, mbledh informacionin për monitorimin e subjekteve mbështetur në:
 - a) Vëzhgimin e drejtpërdrejtë të aktiviteteve të partisë politike, subjektit zgjedhor, kandidatëve të tyre, dhe të organeve të administratës shtetërore qendrore ose vendore, si dhe titullarëve të tyre;
 - b) Intervistat me kandidatët ose kryetarët/përfaqësuesit e partive politike, drejtuesit e fushatës së partive politike/subjekteve zgjedhore si dhe stafit mbështetës të tyre;
 - c) Vëzhgimin e drejtpërdrejtë të materialeve propagandistike elektorale dhe zyrave elektorale;
 - ç) Vëzhgimin e drejtpërdrejtë të eventeve, takimeve apo veprimtarive që mbajnë partitë politike, subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre.
 - d) Vëzhgimin e mediave, vëzhgimi i shtypit qendror dhe lokal.



3. Monitorimi nuk duhet t'i ekspozojë monitoruesit ndaj rreziqeve të panevojshme.
4. Monitorimi nuk kërkon që monitoruesit të llogarisin shpenzimet totale për periudhën e monitorimit nga partia politike, subjekti zgjedhor ose kandidatët ose variablat e ndryshme financiare, që kërkojnë mbledhje të metadatave të zgjeruara.
5. Monitoruesi ka të drejtë të kërkojë nga subjektet që i nënshtrohen monitorimit sipas këtij udhëzimi, të vendosin në dispozicion të tij informacionin për veprimtaritë e tyre. Kërkesa nga monitoruesit paraqitet me shkrim dhe në rast se marrësi nuk i përgjigjet asaj brenda 3 ditësh, monitoruesi njofton menjëherë Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve.
6. Monitoruesi duhet të informojë në formë elektronike Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve në rast konstatimi të shkeljes, në të njëjtën ditë që bëhet vëzhgimi sipas formatit të miratuar për këtë qëllim nga Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mund t'i kërkojë monitoruesit informacion për shkelje të pretenduara.
7. Monitoruesi duhet të depozitojë në format elektronik si dhe fizikisht raportet e ndërmjetme te Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çdo 10 ditë nga fillimi i periudhës së monitorimit deri në ditën e zgjedhjeve sipas formatit të miratuar për këtë qëllim. Format i raportimit përcaktohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
8. Jo më vonë se 7 ditë pas datës së zgjedhjeve monitoruesit depozitojnë tek Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Raportin Përfundimtar të Monitorimit, sipas standartit të përcaktuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Neni 6

Kriteret dhe mënyra e aplikimit

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve 1 (një) vit para muajit të përafërt të mbajtjes së zgjedhjeve të radhës lajmëron nëpërmjet shpalljes publike thirrjen për të aplikuar për të qenë monitorues të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Aplikimi kryhet në mënyrë elektronike në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ose dorëzohet fizikisht pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
2. Kriteret për të aplikuar si monitorues janë si vijon:
 - a) Të ketë përfunduar së paku studimet e nivelit 5 të kornizës shqiptare të kualifikimeve (KShK);
 - b) Të jetë i padënuar;
 - c) Aplikanti, të mos ketë qenë në 2 vitet e fundit anëtar i ndonjë partie politike dhe



prindërit, bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët madhorë të mos jenë anëtarë të ndonjë partie politike.

3. Aplikantët për monitorues duhet të paraqesin dokumentacionin si më poshtë:
 - a) Kërkesën për t'u emëruar si monitorues që përmban arsyet e aplikimit, përvojën e aplikantit dhe të dhënat për kontaktin e tij;
 - b) Diplomë të nivelit të parë (bachelor) ose certifikatë profesionale që dëshmon nivelin 5 të KShK lëshuar nga një institucion i arsimit të lartë i akredituar;
 - c) Të paktën një referencë nga punëdhënës i tij aktual ose i mëparshëm, ose pedagogë të institucioneve të arsimit të lartë;
 - ç) Kopje të dokumentit të identifikimit;
 - d) Vetëdeklarim që nuk është i dënuar;
 - dh) Vetëdeklarim se nuk është dhe nuk ka qenë për dy vitet e fundit anëtar i ndonjë partie politike dhe se prindërit, bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët madhorë nuk janë anëtarë të një partie politike;
 - e) Raport mjeko-ligjor.
4. Në momentin e regjistrimit të kandidatëve për deputetë, kryetarë të bashkisë ose anëtarë të këshillit bashkiak monitoruesit depozitojnë formularin e dytë për mungesën e konfliktit të interesit. Në këtë rast monitoruesit deklarojnë se nuk janë në konflikt interesi për shkak se nuk kanë prindërit, bashkëshortin/bashkëshorten, bashkëjetuesin/en ose fëmijët madhorë kandidatë të subjekteve zgjedhore dhe vijimin e respektimit të përcaktimit të bërë sipas shkronjën “dh”, të pikës 3, të këtij neni. Në të kundërt monitoruesit i ndërpritet kontrata e shërbimit dhe zëvendësohet në këtë detyrë nga një monitorues tjetër.
5. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miraton formularët për zbatimin e pikës 3, të këtij neni. Formularët janë dokumente zyrtare dhe mosdeklarimi i saktë i të dhënave ose deklarimi i rremë i tyre passjell përgjegjësi penale ose administrative për deklaruesin sipas ligjit.

Neni 7

Verifikimi paraprak dhe procedura e certifikimit si monitorues

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nëpërmjet strukturës përgjegjëse të administratës brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga përfundimi i afatit të aplikimit, bën verifikimin paraprak të aplikantëve për plotësimin e kritereve formale në bazë të dokumentacionit të depozituar dhe i propozon Komisionerit listën paraprake.
2. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, miraton me vendim listën paraprake të monitoruesve



brenda 10 ditëve nga verifikimi paraprak sipas pikës 1 të këtij neni.

3. Në fazën e dytë të konkurimit, aplikantët e përzgjedhur i nënshtrohen një trajnimit nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe në përfundim të tij testohen për anën teorike dhe praktike të njohurive për Kodin Zgjedhor dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.
4. Në përfundim të testimit, struktura përgjegjëse e administratës së Komisionerit, harton listën e kandidatëve fitues të testimit që kanë marrë më shumë se 60 (gjashtëdhjetë) përqind të pikëve në testim dhe e paraqet atë për miratim te Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.
5. Kundër vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për miratimin e listës paraprake dhe listës së fazës së dytë të konkurimit personat e skualifikuar mund të bëjnë ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e listës paraprake.
6. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miraton listën e kandidatëve fitues për monitorues dhe i pajis ata me Certifikatën e Monitoruesit. Certifikata merret vetëm një herë dhe monitoruesi i certifikuar i nënshtrohet trainimeve vijuese të organizuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Monitoruesit regjistrohen në Regjistrin e Monitoruesve që mbahet dhe përditësohet nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Neni 8

Procedura e caktimit

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve cakton me short monitoruesit. Si rregull, shorti hidhet publikisht jo më vonë se 2 muaj përpara fillimit të periudhës së monitorimit. Procedura e hedhjes së shortit për caktimin e monitoruesve dhe zëvendësuesve të tyre organizohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
2. Monitoruesit e certifikuar kanë të drejtë të jenë të pranishëm në hedhjen e shortit. Pas hedhjes së shortit për caktimin e monitoruesve vijohet me shortin për kandidatët zëvendësues të monitoruesve në rast të krijimit të vakancës prej tyre.
3. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendim të arsyetuar, mund të përjashtojë nga procedura e shortit monitorues, të cilët nuk kanë përmbushur detyrimet kontraktuale me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
4. Komisioneri mund të vendosë të përjashtojë nga shorti gjithashtu edhe monitorues që kanë qenë caktuar vetëm në zgjedhjet pararendëse, me qëllim që tu krijohet mundësia edhe monitoruesve të tjerë të caktohen në një detyrë të tillë.



5. Monitoruesit e përzgjedhur me short ftohen të nënshkruajnë kontratën e shërbimit. Në çdo rast kontrata fillon të zbatohet 4 muaj para datës së zgjedhjeve.

Neni 9

Informimi i publikut

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve informon publikisht fillimin e procesit të monitorimit si përgjegjësi e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në kohën e emërimit të monitoruesve, si dhe paraqet rregullisht informacion në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për veprimtarinë dhe rezultatet e punës së monitoruesve gjatë periudhës zgjedhore.
2. Monitorimi i subjekteve të monitorimit sipas këtij udhëzimi dhe rezultatet e tij bëhen pjesë e Raportit Vjetor që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve paraqet në Kuvend.

Neni 10

Monitoruesit e zgjedhjeve të përgjithshme të datës 25 Prill 2021

1. Për zgjedhjet e përgjithshme që mbahen në 25 prill 2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve brenda 72 (shtatëdhjetë e dy) orësh nga data e miratimit të këtij udhëzimi bën thirrjen publike për të aplikuar për monitorues.
2. Afati i aplikimit dhe i depozitimit të dokumentave të kërkuara nga ky udhëzim është 7 (shtatë) ditë nga data e lajmërimit sipas pikës 1 të këtij neni.
3. Pas përfundimit të periudhës së aplikimit një komision i posaçëm i ngritur me urdhër të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve realizon, brenda 2 ditëve, verifikimin e plotësisimit të kriterëve formale të përcaktuara në nenin 6 të këtij udhëzimi, harton listën paraprake të kandidatëve dhe ia dërgon për miratim Komisionerit. Brenda 5 ditëve nga miratimi i listës paraprake, komisioni i posaçëm kryen procedurën e intervistimit me kandidatët e kualifikuar me qëllim vlerësimin e aftësive komunikuese e qasjes sociale të tyre dhe i paraqet Komisionerit listën përfundimtare të kandidatëve që mund të hidhen në short për të qenë monitorues të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2021.
4. Lista përfundimtare miratohet menjëherë nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe brenda 2 (dy) ditëve hidhet shorti për caktimin e monitoruesve.
5. Monitoruesit e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2021 i nënshtrohen trainimit vazhdues të organizuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përgjatë periudhës së monitorimit dhe pajisen me certifikatë.



Neni 11

Dispozitë tranzitore për zgjedhjet e përgjithshme 2021

Për zgjedhjet e përgjithshme të datës 25 prill 2021, monitoruesit emërohen jo më vonë se data 15 shkurt 2021 dhe periudha e monitorimit shtrihet deri në datën 25 prill 2021.

Neni 12

Shfuqizime

Udhëzimi nr. 2, datë 01.06.2017, i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të përzgjedhjes së listës paraprake dhe emërimit të ekspertëve financiar për monitorimin e fushatës zgjedhore”, shfuqizohet.

Neni 13

Hyrja ne fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

